



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 129/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 04. 07. 2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe neni 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport datë 03.07.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për vlerësim të gjendjes fizike të zhveshtoreve të stadionit të futbollit "Ferki Aliu" në Vushtrri.
2. Në përbërje të komisionit caktohen:
 - 2.1 Fazli Muharremi, kryesues
 - 2.2 Qemajl Hasani, anëtar
 - 2.3 Sabri Dallku, anëtar
3. Komisioni për punën e tij do të paraqes raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRA

02 Nr. / Br 1213/24

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 15.07.2024

VUSHTRRI - VUÇITRA



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 4 të Rregullores (KKV) nr. 01/2023, prot. nr. 47/23, datë 23.02.2023 për Ndarjen e Bursave për Nxënës Studentë dhe Shpërblimeve për Nxënës she Student të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të kërkesës të Drejtorisë për Arsim 10Nr.744/24, dt. 10.07.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet ndarja e mjeteve financiare për shpërblime për nxënës që kanë arritur rezultate të larta në testin e arritshmërisë dhe në testin e maturës për vitin shkollor 2023/2024 si vijon:

Për testin e maturës:

- 1.1 Siona Mustafa, nxënëse e Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtri ka arritur vendin e parë me 91 pikë, të shpërblehet me 100 euro;
- 1.2 Antigona Gashi, nxënëse e Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtri ka arritur vendin e dytë me 86 pikë, të shpërblehet me 75 euro;
- 1.3 Elmedina Rama, nxënëse e Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtri ka arritur vendin e dytë me 86 pikë, të shpërblehet me 75 euro;
- 1.4 Sara Meniqi, nxënëse e Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtri ka arritur vendin e dytë me 86 pikë, të shpërblehet me 75 euro;
- 1.5 Rizonë Hyseni, nxënëse e Gjinnazit "Eqrem Çabej" Vushtri ka arritur vendin e tretë me 85 pikë, të shpërblehet me 50 euro;

Për testin e arritshmërisë:

- 1.1 Anisë Kutllovci, nxënëse e SHMU-2 Vushtri ka arritur vendin e parë në testin e arritshmërisë me 184 pikë, të shpërblehet me 100 euro;
- 1.2 Urtë Thaçi, nxënëse e SHMU-1 Vushtri ka arritur vendin e dytë në testin e arritshmërisë me 174 pikë, të shpërblehet me 75 euro;
- 1.3 Melika Tiriqi, nxënëse e SHMU-2 Vushtri ka arritur vendin e dytë në testin e arritshmërisë me 169 pikë, të shpërblehet me 50 euro;

2. Pagesa e mjeteve nga pika paraprake e këtij vendimi bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Arsim – kategoria subvencione dhe transfere.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Arsim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për Arsim
- Arkivit



Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 43 paragrafi 14 dhe neni 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në propozimin e Drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport datë 11.07.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për vlerësim të gjendjes fizike të Palestrës Sportive në fshatin Samadrexhë në këtë përbërje:
 - 1.1 Nexhat Merovci, kryesues
 - 1.2 Arben Mlinaku, anëtar
 - 1.3 Afrim Basholli, anëtar
2. Komisioni, lidhur me gjendjen e konstatuar do të paraqes raport me shkrim duke propozuar masa me propozim të masave për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITEN

02 Nr./Br. 1265/24

Nr. i lq./ Br. sh.

Data: / Datum 29.07.2024

VUSHTRRI - VUÇITEN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim shtyhet në afat të pacaktuar implementimi i projektit **“Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësorë në Komunën e Vushtrrisë”** në bashkëfinancim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim TIKA.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim TIKA **nr. 242/24** të datës 14.03.2024 për projektin **“Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësorë në Komunën e Vushtrrisë”** Komuna e Vushtrrisë dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim TIKA kanë shpallur thirrjen për aplikim me datë 15.04.2024 me nr. 16006/24.

Në këtë thirrje për aplikim sipas Memorandumit të bashkëpunimit kanë qenë të paraparë 70 fermer përfitues. Gjate kohës sa ka qenë e hapur thirrja për aplikim prej datës 15.04.2024 deri me datë 26.04.2024 kanë aplikuar një numër i madh i fermerëve - gjithsej 584 aplikues.

Gjate fazës së shqyrtimit të aplikacionit komisioni i përbërë nga përfaqësues të komunës dhe TIKA-s ka shqyrtuar me kujdes secilin aplikacion veç e veç duke bërë përpjekje maksimale që të zbatohen në përpikëri kriteret e shpallura përmes thirrjes, por që për shkak të numrit të madh të aplikacioneve dhe në anën tjetër numrit të kufizuar të pajisjeve bujqësore që do të ndaheshin për fermerë nuk ka pasur asnjë mundësi që të përfshihen të gjithë ata fermer të cilët i plotësonin kriteret sipas thirrjes. Andaj bazuar në të cekurat më lart dhe duke u gjendur në një situatë të pa favorshme për të vendosur për listën përfundimtare të përfituesve u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Projekti në fjalë shtyhet për një afat të pacaktuar derisa të krijohen rrethana tjera që mundësojnë një numër më të madhe përfituesve të fermerëve tanë, ku te gjithë ata që i plotësojnë kriteret e parapara do të përfitonin nga ky projekt.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- Arkivit